

UDHËZIM
Nr.14, datë 16.6.2011

PËR PAGESËN E DETYRIMEVE NDAJ TË TRETËVE TË NDËRMARRJEVE DHE SHA-VE NË PRONËSI TË PUSHTETIT VENDOR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.10 340, datë 28.10.2010 “Për pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve të ndërmarrjeve dhe sh.a.-ve, në pronësi të pushtetit vendor”, Ministri i Financave, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZOJNË:

1. Në rastet kur ndërmarrjet publike dhe/ose sh.a.-të, në pronësi të pushtetit vendor, nuk paguajnë në kohë detyrimet e tyre ndaj të tretëve, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për pagimin e tyre.

2. Për rastet kur ndërmarrjet dhe/ose sh.a.-të subvencionohen nga pushteti qendror dhe/ose vendor, Ministri i Financave, nëpërmjet degëve të thesarit në rrethe, verifikon arsyet e mospagesës së detyrimit ndaj të tretëve vetëm për çështjet që lidhen me interesat jetikë dhe bazë të komunitetit (furnizimin me ujë të pijshëm, pastrimin e mbeturinave, kanalizimet etj.).

3. Pas kryerjes së verifikimit të mësipërm, Ministri i Financave, me anë të një shkrese, i kërkon njësisë së qeverisjes vendore, marrjen e masave për zgjidhjen e problematikës së krijuar me ndërmarrjen publike dhe/ose sh.a.-të, në pronësi të saj, duke e vënë në dijeni të sanksioneve ligjore të cilave do t’u nënshtrohet në rast të moszgjidhjes së problemit.

4. Njësia e qeverisjes vendore, me marrjen e shkresës, është e detyruar që brenda një afati kohor prej 30 ditësh, të marrë masa për zgjidhjen e problemit, si dhe të raportojë pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me masat dhe afatin kohor të zgjidhjes së problemit.

5. Në rastin kur njësia e qeverisjes vendore nuk respekton afatin kohor të raportimit të kërkuar në pikën 4 të këtij udhëzimi, si dhe në rastin kur ajo (NJQV) nuk e zgjidh problemin brenda afatit kohor të deklaruar, Ministri i Financave, me anë të një shkrese të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe të Thesarit, urdhëron degën e thesarit, në juridiksionin e së cilës ndodhet njësia e qeverisjes vendore, të bllokojë të gjitha veprimet financiare të saj, me përjashtim të veprimeve që kanë të bëjnë me pagesën e shpenzimeve të personelit, si dhe ato për ushqimin dhe ngrohjen në kopshte, çerdhe, qendra sociale dhe shkolla.

6. Me kryerjen e bllokimit të fondeve, përgjegjësi i degës së thesarit, me anë të një shkrese, duhet të njoftojë menjëherë Ministrinë e Financave. Njësia e qeverisjes vendore do të qëndrojë e bllokuar deri në momentin e paraqitjes së urdhërpagesës së likuidimit të detyrimit, apo të një kontrate/marrëveshje të shlyerjes së detyrimit me këste, të firmosur nga kryetari i njësisë dhe autoriteti përgjegjës i institucionit ndaj të cilit ka lindur detyrimi.

7. Në momentin e paraqitjes së urdhërpagesës apo kontratës, përgjegjësi i degës së thesarit njofton Ministrinë e Financave dhe kryen zhblokimin e fondeve. Në rast të dorëzimit të një kontrate për shlyerje me këste të detyrimit, dega e thesarit kryen kontrollin/ndjekjen e likuidimit të këtyre kësteve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode
MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi
MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGETIKËS
Nasip Naço